REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr.6837 Prot.

Lushnje, më 08 / 08 /2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK

KËTU

"MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT,SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TE KREDISË"

Në zbatim të programit "Subvencionimi i Interesave të Kredisë" për familjet e pastreha, me fonde të buxhetit të shteti, Bashkia Lushnje po zbaton këtë program deri në plotësim të kuotave të vëna në dispozicjon nga MFE.

Kushtet kryesore që duhet të plotësojë aplikanti për të përfituar nga ky program social sipas ligjit të strehimit janë:

1- Të vërtetojnë se nuk kanë banesë në pronësi dhe nuk kanë kryer asnjë transaksion për tjetërsimin e saj të paktën në 5 vitet e fundit, përvec rastit kur pronësia mbi to ka humbur për shkak të një fatkeqësie(vdekje apo sëmundje e rëndë) ose forcë madhore.
2- Kanë të ardhura familjare/individuale mujore jo më të larta se të ardhurat mesatare të njësisë së vetqeverisjes vendore përkatese (Bashkia Lushnje), sipas përcaktimit të pikës 45, neni 2 I ligjit të strehimit "të ardhura mesatare" është niveli mesatar i konsumit familjar sipas nivelit më të ulët territorial të disagregimit të të ardhurave nga INSTAT-I dhe që publikohen në mënyrë periodike.

Ky program synon të mbështesë individë/familje në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmisimin e cilësisë të jetesës. Prioritet i jepet famlijeve të reja ,me moshë ,të anëtarit më të madh më pak ose baraz me 40 vjec,individë me moshë jo më shumë se 40 vjec, gra kryefamiljare apo individë/familje të minoritit rom egjiptian.

më pak ose baraz me 40 vjec,individë me moshë jo më shumë se 40 vjec, gra kryefamiljare apo individë/familje të minoritit rom egjiptian.

Kategoritë e cilësuara më lart përbëjnë përparësi, por nuk përjashtojnë katgoritë e tjera prioritare që përcakton neni 16 i ligjit nr.22/2028 "Për strehimin social" i ndryshuar. Në përgjigje të njoftimit publik te datës 16 Qershor deri në 18 Korrik 2025 i publikuar në websitin zyrtar të Bashkisë Lushnje thirrjes për "aplikime-kërkesë për të përfituar strehim nga subvencionimi i interesave të kredisë", në sistemin on-line të strehimit, nëpërmjet portalit qeveritar e-Albania.Në sistem kanë aplikuar 12 familje, ku prej tyre vetem pesë familje e kaluan komisionin.Administrimi i kërkesave për të përftuar nga ky program u krye në zbatim të kuadrit ligjor dhe përzgjedhje e familjeve përfituese nga ky program u krye në zbatim të kuadrit ligjor dhe përzgjedhja e familjes përfituese bëhet sipas sistemit të pikëzimit, miratuar me vendimin nr.99 datë 26/11/2024 të Këshillit Bashkiak.

Kushtet e dhënies së kredisë bazohen në Marrëveshjen dypalëshe "Për kreditimin në Kuadër të Programit të Banesave me Kosto të Ulët për Familjet që përfitojnë Subvencionimin e Interesave të Kredisë" nënshkruar midis palëve, Ministria së Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Intesa San Paola dhe familjet përfitojnë kredi me interes jo më të lartë se 3% dhe me afat maksimal 30 vjet. Diferenca midis interesit te kredisë hipotekore dhe interesit 3% të kredisë së lehtësuar subvencionohet nga buxheti i shtetit.

Në zbatim të :

-Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

-Ligjit nr.22/2018 "Për Strehimin Social I ndryshuar, neni 15,16,47,47/1.

-VKM nr.384, datë 12.06.2019, 'Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore".

-VKM Nr.29.04.2022 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM Nr.453, datë 03.07.2019. "Për masën e subvecionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuar nga shteti".

Lista përmban 5(pesë) familje pët tu trajtuar nga ky program sipas formatit të listës bashkangjitur projekt-vendimit (tabela 2).

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr 6837 Prot.

Lushnje, më 08 / 08 /2025

PROJEKT - VENDIM

NR. 76 DATË 08 / 08 /2025

"MBI MIRATIMIN E FAMILJEVE QE PEFITOJNE NGA PROGRAMI SOCIAL I STREHIMIT,SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TE KREDISE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës___/___/2025 pasi analizoi relacionin e paraqitur nga zyra e Strehimit dhe në mbështetje të Ligjit nr.22/2028 "Për Strehimin Social, nenin 47, 15, pikat 1,2,3, të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", VKM 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" VKM nr.453, datë 03.07.2029" për masën e subvecionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet, që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësua nga shteti" i ndryshuar me VKM nr.268, VKM nr.301, dtë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit" dhe V.K.B nr.99 datë 26.11.2024 "Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për programet e strehimit social për vitin 2025" Këshilli Bashkiak

PROPOZOJMË :

1.Miratimin e pesë familjeve të cilat përfitojnë nga programi social "Subvencionimi i Interesave të Kredisë" sipas listës bashkëngjitur.

2.Familjet e përcaktuara në listën fituese, të këtij vendimi, të paraqiten pranë institucioneve financiare si : "Banka Raiffeisen", "Banka Kombëtare Tregtare" dhe "Banka Intesa SanPaolo" mbas njoftimit zyrtar që kryen Bashkia Lushnje.

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Strehimit dhe Drejtoria e Financë- Buxhetit.

4.Vendimi hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtoria Shërbimit Social

Anila Cela

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Kryetari i Bashkisë

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL DHE KUJDESIT SHËNDETËSOR

PROGRAMI I SUBVENCIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË

TABELA NR.2- FORMATI I LISTËS EMËRORE



Nr.	Emri / Atësia / Mbiemri	Përberja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, gërma(a)	Kushtet familjare (neni16, gërma (b)	Kushtet sociale (neni,16 gërma (c)	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Vlera maksimale e apartamentit që përfiton në lekë	Piket nga sistemi pikezimit
1	Anita Shpëtim Baçevani	3	2+1	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	E Divorcuar	50,030 lekë	Privat	3,640,950	21
2	Besmir Vangjel Zaka	4	2+1	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	Famlijeve të reja me moshë të anëtarit më të madh më pak ose baraz me 40 vjec	Familje te mbipopulluara	82,019 lekë	Privat	3,640,950	20
3	Eltona Sherif Çela	2	1+1	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku	E Divorcuar dhe PAK	51,888 lekë	Privat	2,472,250	21

					përfshihen edhe vajzat nëna					
4	Ornela Ismail Skraqi	3	2+1	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	E Divorcuar	60,000 lekë	Privat	3,640,950	21
5	Mirela Ilir Begaj	3	2+1	Nuk disponojnë banesë në pronësi;	Familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;	E Divorcuar	44,423 lekë	Shtet	3,640,950	21

DREJTORIA SHËRBIMIT SOCIAL

Anila Çela